

<b>1.Pozicioni i punës:</b> Shofer
<b>2. Kodi i pozicionit:</b> LT 2151 Tirane
<b>3. Reparti/Institucioni:</b> 4007 Komanda Mbështetëse
<b>4. Vendi:</b> Pezë - Helmës Tiranë
<b>5. Paga:</b> Sipas VKM-së, nr.717, datë 23.6.2009
<b>6. Lloji i kontratës së punës:</b> Për një kohëzgjatje të përcaktuar
<b>7. Data e fillimit të aplikimit:</b> 12.03.2019
<b>8. Data e mbylljes së aplikimit:</b> 26.03.2019
<p><b>9. Mënyra e aplikimit:</b></p> <p>Për të aplikuar kandidatët duhet të plotësojnë formularin e aplikimit, të cilin do ta gjejnë në faqen e internetit të Ministrisë së Mbrojtjes në adresën <a href="http://www.mod.gov.al">www.mod.gov.al</a>. Formulari pasi plotësohet, së bashku me dokumentacionin përkatës, do t'i dërgohet Njesisë së Personelit të Strukturës që është e interesuar për rekrutimin, brenda afatit të caktuara, në zarf, dorazi ose në rrugë postare në adresën ( adresa postare e repartit/strukturës përkatëse):</p> <p><i>Degës së Personelit</i>  <i>Komandës Mbështetëse</i>  <i>Vaqarr</i>  <i>Tiranë</i></p>
<p><b>10. Dokumentet e aplikimit:</b></p> <p>Aplikantët duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ kërkesën;</li> <li>▪ formularin e aplikimit;</li> <li>▪ fotokopje të kartës së identitetit;</li> <li>▪ diplomën e shkollës së mesme/parauniversitare ose të lartë të noterizuar ose në original;</li> <li>▪ fotokopje të patentës;</li> <li>▪ dëshmi profesioni nëse ka;</li> <li>▪ certifikatë ose dëshmi të gjuhëve të huaja</li> <li>▪ raport mjekësor;</li> <li>▪ fotografi me përmasa 4x6, 2 copë;</li> <li>▪ dëshmi penaliteti;</li> <li>▪ vërtetim nga gjykata;</li> <li>▪ vërtetim nga prokuroria;</li> <li>▪ librezë pune;</li> <li>▪ jetëshkrimin (CV).</li> <li>▪ formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në faqen e internetit të MM-së në adresën elektronike <a href="http://www.mod.gov.al">www.mod.gov.al</a>. (linku: <i>Baza ligjore/Akte ligjore/ Integriteti i personave që ushtrojnë funksione publike/formulari i vetdeklarimit</i>)</li> </ul>
<p><b>11. Kërkesat e përgjithshme të pozicionit të punës:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>a) të ketë shtetësinë shqiptare;</li> <li>b) të jetë jo më pak se 18 vjeç;</li> <li>c) të gëzojë zotësi të plotë për të vepruar;</li> <li>d) të plotësojë kërkesat për llojin dhe nivelin arsimor, si dhe të zotërojë aftësitë profesionale të</li> </ol>

- domosdoshme, për vendin përkatës të punës, sipas kriterëve të miratuara;
- c) të jetë i aftë për punë nga ana shëndetësore;
  - e) të mos jetë të dënuar me burg me vendim gjykate të formës së prerë për kryerje të një krimi;
  - dh) të mos jetë marrë masa disiplinore me largim nga puna, brenda 1 viti nga data e aplikimit.

### 12. Kërkesat specifike të pozicionit të punës:

- a. Grada/Titulli: Civil II
- b. Arsimi : I Mesëm
- c. Kualifikimi: Të ketë kryer kualifikim të nevojshme në fushën mirëmbajtjes së automjeteve teknikës
- d. Trajnimi: Të jetë i pajisur me Leje Drejtimi, dhe deshmi në fushën e transport mirëmbajtjes
- e. Eksperienca në Punë: Mbi 5 vjet

### 13. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve:

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nga një **komision vlerësimi** i përbërë nga 3 (tre) veta.  
Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve përfshin:

- përzgjedhjen paraprake;
- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën përkatëse;

Përzgjedhja paraprake e kandidaturave do të realizohet nga Njësia e personelit të strukturës që është e interesuar për rekrutimin, mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët. Njësia e personelit verifikon dokumentacionin e aplikantëve, nëse ai është i plotë dhe i saktë, si dhe plotësimin e kërkesave të pozicionit të punës nga ana e tyre dhe përcaktonë kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit. Vetëm kandidatët që plotëojnë kërkesat e pozicionit do të njoftohen për vazhdimin e mëtejshëm të konkurrimit.

Konkurimi me kandidatët që plotësonë kërkesat e pozicionit të punës përfshin:

- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve (vlerësimin e arsimimit/kualifikimit, vlerësimin e trajnimit dhe vlerësimin e eksperiencës të lidhura me fushën përkatëse;

Vlerësimi i tyre do të bëhet nga komisioni përkatës.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 (njëqind), të cilat ndahen:

**Vlerësimi i dokumenteve** të kandidatëve përfshin:

- a. vlerësimin e jetëshkrimit (CV);
- b. vlerësimin e kualifikimeve akademike, profesionale dhe teknike;
- c. vlerësimin e trajnimeve;
- d. vlerësimin e eksperiencave të ngjashme të punës;

Pikët totale të vlerësimit të dokumenteve ndahen, si më poshtë:

- a. jetëshkrimi, 5 pikë;
- b. arsimimi/kualifikimi, 15 pikë;
- c. trajnimi, 5 pikë;

d. eksperiencia/përvoja në punë, 15 pikë.

Në mbyllje të procesit të vlerësimit, tre kandidatët që kanë marrë më shumë pikë i paraqiten autoriteteve vendimarrëse për miratimin e kandidatit më të përshtatshëm për mbulimin e pozicionit të shpallur.

Me emërimin në pozicionin e punës do të lidhet kontrata individuale e punës.